



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo



Komuna e Prishtinës
Opština Priština –Municipality of Prishtina

DREJTORIA E ARSIMIT

03 Nr. 300, dt: 14.09.2015

Duke u mbështet në nenin 62, paragrafi 3 të Ligjit nr. 03/L – 040 për vetëqeverisjen lokale (“Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës”, nr. 28/2008), nenin 57 shkronja e. të Statutit të Komunës së Prishtinës, 01. nr. 110-391, dt. 25.2.2010, bazuar në objektivat për menaxhimin e parasë publike, drejtori i Drejtorisë për Arsim me datë 14.09.2015, merr këtë:

V E N D I M

PËR KOMPENSIMIN E PUNËS SEKONDARE PËR STAFIN MËSIMOR DHE JO MËSIMOR NË INSTITUCIONET EDUKATIVO-ARSIMORE

1. Ky vendim ka për qëllim:

- 1.1 Të ndërtoj një shërbim arsimor të shëndosh, të ndershëm dhe në përputhje me parimet e përcaktuara.
- 1.2 Shfrytëzimin sa më efikas dhe të ndershëm të buxhetit të konsoliduar të Kosovës bazuar në objektivat e menaxhimit të parasë publike;
- 1.3 Punësimin e ligjshëm dhe sa më madh të kadrove të cilët janë të papunë;
- 1.4 Rregullimin e pagave të nëpunësve në shërbimin arsimor të Kosovës dhe të cilat paga realizohen nga Buxheti i Konsoliduar i Kosovës;
- 1.5 Të përcakton rregullat dhe të drejtat e nëpunësve të angazhuar në më shumë se një vend të punës.

2. Nga buxheti i konsoliduar i Kosovës lejohet marrja e vetëm të një page dhe vetëm një mënyrë e kompensimit për të drejtat e pushimeve sipas ligjit të punës.

3. Të punësuarit që me vullnetin e tyre kanë zgjedhë Drejtorinë e Arsimit si punë sekondare, kompensohen vetëm me 50% të pagës për orët e mbajtura gjatë muajit.

4. Nëpunësve sipas pikës 3 të këtij vendimi nuk ju takon asnjë kompensim tjetër nga marrëdhënia e punës për pushimin vjetor, mjekësor, të lehonisë etj, sepse të njëjtit këto të drejta i realizojnë në vendin primarë të punës, e jo dyfishim i këtyre të drejtave në kundërshtim me ligjin e punës, në dëm të buxhetit të konsoliduar të Kosovës.

Faqe 1 nga 1



5. Autorizohet drejtori i shkollës që pas hyrjes në fuqi të këtij vendimi, në afat prej 5 ditësh ti identifikoj listat e pagave dhe nga nëpunësit që marrin më tepër se një pagë nga buxheti i konsoliduar i Kosovës të kërkoj që në afat prej 15 ditësh të deklarohen se cilën pagë dëshiron ta mbajë si pagë kryesore dhe cilën pagë si pagë sekondare.
6. Në rast se nëpunësi zgjedh DKA si punë sekondare, obligohet të sjell një kopje të vendimit dhe kontratën e punës primare në dosjen personale në arkivin e IEAA-së.
7. Në çdo fillim të vitit shkollor të gjithë të punësuarat në më shumë se një vend pune që paguhet nga buxheti i Kosovës, duhet të deklarohen për punës sekondare në drejtorinë e IEAA-së. Mos deklarimi i tyre nënkupton fshehje nga obligimet dhe detyrat zyrtare në raport me punëdhënësin.
8. Për respektimin e këtij vendimi kujdesën drejtorët e IEAA-ve, zyrtarët financiar dhe zyrtarët për paga në DKA.
9. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Vendimi i dërgohet:

- MASHT-it
- Shkollave
- Inspektoratit të Arsimit
- Inspektoratit të Punës
- DKA -së

DREJTORIA E ARSIMIT


Arbërie Nagavci,
drejtoreshë

